



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 611/ 2010

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), i përbërë nga Nehat Idrizi kryesues, Ferit Osmani dhe Rafet Haxhaj anëtarë, përkritazi me ankesat e parashtruara prej subjekteve politike Fryma e Re (FER), Lëvizja Vetëvendosja (LVV), Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK) dhe Partia Demokratike e Kosovës (PDK) ne lidhje me mospërputhje të rezultateve preliminare zgjedhore, në seancën e mbajtur më 17.12.2010, mori:

VENDIM

HIDHEN si të palejuara ankesat me numër lende A611, A613, A614, A615, A623, A625, A626, A628, A630, A635, A636, A641, A645, A646, A650, A651, A652, A653, A654, A655, A656, A657, A658, A659, A660, A661, A663, A664, A665, A666, A667 dhe A668 të subjekteve politike Fryma e Re (FER), Lëvizja Vetëvendosja (LVV), Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK) dhe Partia Demokratike e Kosovës (PDK)

ARSYETIMI

Më datë 13.12.2010, 14.12.2010, 15.12.2010, 16.12.2010 dhe 17.12.2010, PZAP-i ka pranuar 32 (tridhjetë e dy) ankesa në të cilat pretendohet se:

A611 (PDK kundrejt kryesuesit të VV-se) - Në vendvotimin (VV)2515D, shkolla fillore “Dëshmoret e Koshares”, Koshare, kandidatja e PDK-se Lumnide Morina Nr-42 është demtuar pasi votat e saj janë bartur tek kandidatet e subjekteve të tjera politike;

A613 (PDK kundrejt kryesuesit të VV-se) - Në vendvotimin (VV)2515D, shkolla fillore “Dëshmoret e Koshares”, Koshare, kandidati e PDK-se, Bahri Hyseni është demtuar duke i bartur votat e tij tek kandidatet e subjekteve të tjera politike;

A614 (PDK kundrejt kryesuesit të VV-se)- VV 2511, Ferizaj, votat e Bahri Hysenit kandidat i PDK-se janë përshkruar gabimisht për kandidatin Abdyl Ymeri (PDK);

A615 (PDK kundrejt kryesuesit të VV-se)- VV2710B/nr 01R, 03R, 04R dhe 05R, Vushtri, nuk ka pasur numërim të votave, vetëm është shkruar se për kandidatin e PDK-se nr. 104 ka pasur 200 vota. Kërkohej prej parashtruesit që të bëhet rinumërimi i tyre;

A623 (FER përkundrejt QNR-se)- VV0303e/02D dhe 0305e/02D, Gllgovac, ka mospërputhje te shiritave te kutive te votimit;

A625 (FER përkundrejt QNR-se)- Kutisë me numër 2203/01 i ka munguar libri i votimit dhe një kuti me po këtë nume reshte gjetur ne QNR;

A626 (FER përkundrejt QNR-se)- VV 0503/02R është evidentuar se formulari i rezultateve te komisionereve ka munguar, kurse kutia është dorëzuar ne QNR;

A628 (AAK kundrejt QNR-se)- VV 0106c/06R votat e AAK-se i kane kaluar gabimisht subjekteve te tjera politike;

A630 (AAK kundrejt QNR-se) Zelfije Pllana-Idrizi kandidate e AAK-se ka pasur informacion se votat e saj janë manipuluar dhe kërkon prej PZAP numërimin e sakte te votave;

A635 (LVV përkundrejt QNR-se)- Ne VV te papërcaktuar, shkolla “Skenderbeu”, Kacanik, kandidati i LVV-se Enver Bajrami ka humbur 100 vota pasi numri i identifikimit ka qene gabim, me propozim qe te behet rinumërimi i votave ne atë VV;

A636 (AAK përkundrejt QNR-se)- Ne kutinë me numër 2623d/02d, Lubishte-Viti, nuk janë bartur votat te cilat i përkasin kandidateve te AAK-se;

A641 (PDK kundrejt kryesuesit te VV-se)- Ne QV 0701d dhe VV nr. 01-07R, shkolla “Skënderbeu”,Kacanik, formularët nuk janë plotësuar ne baze te votave te fituara por duke i përshkruar kandidateve vota sipas komisionereve, prandaj kërkohet rinumërim ne te gjitha VV e cekura, për te gjithë kandidatet e PDK-se;

A645 (PDK përkundrejt KKZ-se Kacanik)- QV 0713 dhe 0704d, votat e kandidatit te PDK-se nuk janë numëruar dhe evidentuar ne formularët e rezultateve;

A646 (PDK kundrejt komisionereve te PDK-se)- QV 3301d, 3302d, 3303d dhe 3304d, numërimi i votave te cilat i përkasin kandidateve te PDK-se nuk ka qene i sakte;

A650 (FER përkundrejt QNR-se)- Kutia nr. 0401d/19d është hapur per shkak te mosplotësimit te FRP-se si dhe thesi i votave me kusht nuk ka pasur shirit dhe per këtë arsye është mbyllur me spango;

A651 (FER përkundrejt QNR-se)- VV 0405D/02D, Gjilan, ka pasur mospërputhje te shirit te kapakut me atë te shënuar ne FPR;

A652 (FER përkundrejt QNR-se)- Ne kutinë me nr. 1961E/01D, Prishtine, ka pasur mospërputhje te shiritave anësor me ato numra te cilat janë shënuar ne FPR-te;

A653 (FER përkundrejt QNR-se)- Kutia 0402X/04R (komuna e papërcaktuar) ka pasur ndërrim te shiritave , te cilat nuk janë regjistruar ne procesverbal nga stafi i QNR-se;

A654 (FER përkundrejt QNR-se)- Kutia 0402D/09D, Gjilan, ka pasur mospërputhje te shirit te votave me kusht 129693;

A655 (FER përkundrejt QNR-se)- “Kutise 0401X/ 15R, Gjilan, i janë ndërruar shiritat sipas raportit me arsyetim se zarfi nuk gjendet brenda kutise”;

A 656 (FER përkundrejt QNR-se)- “Ne Kutinë 3030A/ 02D, Malisheve, është vendosur gabimisht zarfi i KKZ-se dhe për këtë arsye janë hapur 2 shirita nga stafi, sepse nuk kishte shume vota me kusht” ;

A657 (FER përkundrejt QNR-se)- VV 2713B/ 01R, Vushtrri, nje shirit eshte zëvendësuar me një shirit te gjelbër nr. 327618;

A658 (FER përkundrejt QNR-se)- Kutia 0817C/02D, Kline, është dashur te dërgohet ne karantine pasi rezultatet nuk përputheshin;

AA659 (FER përkundrejt QNR-se)- Kutia 0442D/01D, Gjilan, ka pasur shenje te zeze për shkak te mospërputhjeve te rezultateve por është proceduar si e rregullt;

A660 (FER përkundrejt QNR-se)- Kutia 1905E/06D, Prishtine, nuk ka pasur te shënuar shiritin mbyllës te votave me kusht;

A661 (LVV përkundrejt QNR-se)- Ne kutinë 0309e/02d, Fushe Kosove, ka pasur mospërputhje te numrit te nënshkrimeve dhe numrit te zarfeve te votave me kusht;

A663 (LVV përkundrejt QNR-se)- VV 0406D/01R, VV 0439D/02D, VV0403X/01R, VV0407D/02R, VV0405D/01R, ka pasur mospërputhje te numrave te shiritave me ato te shënuara ne FPR;

A664 (LVV përkundrejt QNR-se)- Ne VV-te, 1901e/05D, 1904e/05R, 1905e/02R, 1905e/04R, 1905e/06D, 1906e/06R dhe 1909e/ 05D, ka pasur mospërputhje te numrave te shiritave me ato te shënuara ne FPR;

A665 (LVV përkundrejt QNR-se)- ne QNR Fushe Kosove është bere shkelje e nenit 3.2 te Rregullës Zgjedhore 09/2009;

A666 (LVV përkundrejt QNR-se)- Ne QNR, kutisë me nr. 2065A-010 i kane munguar 14 nënshkrime prej faqes 247 nga numri 1-14;

A667 (LVV përkundrejt QNR-se)- “PZAP duhet te shqyrtoj formularin e perputhshmerise se kandidateve”; dhe

A668 (LVV përkundrejt QNR-se)- Ne kutinë nr. 1009D/04D, ka pasur mospërputhje ne mes te fletëvotimeve dhe nënshkrimeve, përkatësisht 47 fletëvotime për 42 nënshkrime.

Neni 106 paragrafi 2 i LZP-së, specifikon se:

106.2 “Para certifikimit te rezultatit te zgjedhjeve, KQZ-ja mund te urdhërojë rinumërimin e votave ne cilindo vendvotim, qendër te numërimit ose edhe përsëritjen e votimit ne një qendër votimi apo ne një komune”.

Neni 4.2 dhe 6.3 dhe i Rregullave dhe Procedurave te PZAP parasheh si vijon:

4.2 PZAP-i mund t'i hudhë poshtë (si të palejuara, të parregullta apo të pa-afatshme) ankesat, të cilat nuk i plotësojnë kriteret e parapara në nenin 3 të këtyre rregullave dhe procedurave, apo të cilat nuk janë në përputhje me dispozitat e duhura ligjore. Në rast se ankesa nuk i plotëson këto kriteret, PZAP-i mund t'i japë palës ankuese një periudhë të arsyeshme kohore, siç është paraparë në njoftim, për t'i plotësuar ato kriteret.

6.3 “Me qëllim të lehtësimit të shqyrtimit të ankesave, kryesuesi i panelit mund të vendose ta bej bashkimin e ankesave që perbajne ne vete çeshtje te ngjashme, paneli vendimmarrës i trajton ato si kur te ishin një ankese”.

PZAP gjeti se:

- ankesat janë te palejuara

Bazuar ne vendimin e PZAP me numër lende A490 te dt. 16.12.2010, KQZ-ja ne përputhje me nenin 106. 2 te LPZ, ne dt. 16.12.2010 urdhëroje përsëritjen e votimit ne komunat e Gillogovacit, Decanit dhe Skenderaj. Gjithashtu KQZ-ja ka urdhëruar përsëritjen e votimit ne QV 1304E ne komunën e Lipjanit dhe QV 3008A ne komunën e Malishevës. Rrjedhimisht, rezultatet preliminare te zgjedhjeve te parakohshme parlamentare ne Republikën e Kosovës mund të ndryshojnë si rrjedhim i përsëritjes se votimit ne komunat dhe vendvotimet e komunave te cekura me larte. Duke marre ne konsiderate faktin se do te këtë përsëritje te numërimit te votave dhe se procesi zgjedhor nuk do te konsiderohet i përfunduar deri ne momentin qe rivotimi te jete kryer, PZAP vlerëson se ankesat e subjekteve politike FER, LVV, PDK dhe AAK nuk janë relevante. Për këto arsye si dhe bazuar ne dispozitat ligjore te cituara me larte dhe ne kuptim te nenit 115.1 te LPZ-se, PZAP vendosi si ne dispozitiv te këtij vendimi.

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i, në rast se gjoba e përfshirë është më e lartë sesa pesëmijë (5, 000) Euro ose në rast se çështja prek një të drejtë themelore.*

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

A nr. 611/2010 më datën 17.12.2010.

Kryesuesi i Panelit

Nehat Idrizi

